



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 103

Tiranë – E martë, 29 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 7.6.2021	Për procedurat praktike të krijimit dhe administrimit të inventarit të unifikuar, të përbashkët, për spektrin radio, të përdorur për qëllime komerciale dhe publike..... 9743
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.1289/1, datë 4.5.2021	Për përcaktimin e tarifave të regjistrimit të mjeteve lundruese..... 9746
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 262, datë 21.6.2021	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 243, datë 8.6.2021, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla”..... 9747
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 263, datë 22.6.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 44, datë 26.1.2021, “Për miratimin e kontratës tip për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik”..... 9747
Urdhër i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 120, datë 24.6.2021	Për delegimin e kompetencave për miratimin, publikimin e programit të transparencës dhe të regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar..... 9751
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7614, datë 22.6.2021	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 9751
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 3.6.2021	Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021..... 9751
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 133, datë 7.6.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021..... 9753

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 7.6.2021	Mbi rinovimin e licencës nr. 343, seria f16, për furnizimin e energjisë elektrike të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.....	9755
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 7.6.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	9756
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 7.6.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Info-Telecom” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	9757
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 7.6.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 478, seria t20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, të ndryshuar.....	9758
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 7.6.2021	Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.....	9759
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 15.6.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Green Tech” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 115, datë 26.4.2021, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, për vitin 2020”.....	9761
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 15.6.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k.....	9763
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 15.6.2021	Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2021.....	9765
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Orjenca Zeqiri.....	9774



UDHËZIM

Nr. 3, datë 7.6.2021

**PËR PROCEDURAT PRAKTIKE TË
KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË
INVENTARIT TË UNIFIKUAR, TË
PËRBASHKËT, PËR SPEKTRIN RADIO,
TË PËRDORUR PËR QËLLIME
KOMERCIALE DHE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 5, pika 4, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, pika 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020, “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”,

UDHËZOJ:

1. Në zbatim të programit shumëvjeçar për politikën spektrale, me qëllim planifikimin afatgjatë të përdorimit të spektrit të frekuencave, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) krijojnë inventarin e unifikuar, të përbashkët për spektrin radio, të përdorur për qëllime komerciale dhe publike.

2. Inventari të shërbejë për:

a) identifikimin e brezave të frekuencave ku ka hapësirë për përmirësimin e efikasitetit të përdorimit aktual të spektrit radio, duke konsideruar edhe mundësinë e caktimit/ricaktimit të frekuencave;

b) identifikimin e brezave të lirë të frekuencave që do të garantojnë një përdorim më efikas, për të promovuar inovacionin dhe rritur konkurrencën e tregut brenda vendit;

c) identifikimin e brezave të frekuencave ku ka mundësi për përdorim të përbashkët të spektrit radio dhe duke mbajtur parasysh në të njëjtën kohë dhe kërkesën për shërbime të reja;

d) analizimin e llojeve të ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve si nga sektori publik dhe privat.

3. Format i inventarit të përfshijë grupimet e shërbimeve/aplikimeve si më poshtë:

a) Shërbimet e radiovendndodhjes dhe radio-navigimit aeronautik, detar dhe civil (AMCRN);

b) Radiotelevizion (tokësor);

c) Shërbimet e lëvizshme;

d) Sisteme të mbrojtjes;

e) Lidhjet fikse;

f) Sisteme Inteligjente të Transportit (ITS);

g) Meteorologji;

h) Radio e lëvizshme profesionale/Radio e lëvizshme profesionale me akses publik (PMR/PAMR);

i) Bërja e programit për ngjarje të veçanta (PMSE) dhe mbrojtjes publike dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë (PPDR);

j) Radio astronomi;

k) Sisteme satelitore;

l) Pajisje me rreze të shkurtër (SRD);

m) Sistemet e transmetimit të të dhënave me brez të gjerë.

Për sistemet e mbrojtjes në inventar jepet informacion i kufizuar vetëm për shërbimin/et.

4. Krijimi i inventarit të spektrit radio të kryhet përmes një procesi transparent dhe të fokusuar në aspektin teknik të përdorimit me efikasitet të spektrit. Për të vlerësuar dhe/ose realizuar efikasitetin e përdorimit të spektrit, të përdoren treguesit sasior dhe cilësorë të përdorimit të spektrit.

5. Treguesit e vlerësimit të jenë objektiv dhe të verifikueshëm/të matshëm dhe të bazohen në kriteret e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

a) kriteri i përdorimit;

b) kriteri i tendencave të kërkesës;

c) shtrirja gjeografike;

d) kriterin e bashkëpërdorimit.

Kriteret e vlerësimit mund të rishikohen periodikisht në varësi të zhvillimeve. Në aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepet një orientim për analizën dhe vlerësimin sipas këtyre kriterëve.

6. Inventari të krijohet në format të hapur duke synuar shkëmbimin dhe përditësimin e të dhënave me Sistemin e Informacionit për Frekuencat (EFIS) të krijuar nga Konferenca Europiane e Postave dhe Telekomunikacioneve (CEPT/ ECO).

7. Inventari i spektrit të fokusohet në intervalin e frekuencave nga 400 MHz në 6 GHz, por nuk përjashton përfshirjen e brezave të tjerë, që lidhen me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat në të ardhmen për shërbime të reja.

8. Inventari i spektrit publikohet/është i aksesueshëm për publikun dhe respekton detyrimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave



personale, privatësisë, konfidencialitetit të biznesit dhe sekretin shtetëror.

9. Inventari i unifikuar, i përbashkët për spektrin e administruar nga AKEP-i dhe AMA të krijohet brenda 2021-shit dhe të përditësohet rregullisht 2 herë në vit.

10. AKEP-i dhe AMA bashkëpunojnë për krijimin e inventarit të unifikuar, të përbashkët, të spektrit radio. Për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave, në lidhje me frekuencat në EFIS, caktohet një person kontakti përkatësisht nga AKEP-i dhe AMA, duke njoftuar për këtë ministrinë dhe CEPT-in.

11. Kopje e inventarit ose aksesit në formatin elektronik të tij, si dhe rezultatet e analizës për çështjet e përmendura në pikën 2 të këtij udhëzimi, i paraqiten ministrit me krijimin e inventarit dhe pas çdo përditësimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKS

Orientim për analizën/vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të spektrit sipas kriterëve:

Kriteri i përdorimit

Përdorimi i spektrit të radios, tregon masën/shkallën se sa nga burimet aktuale të spektrit të disponueshëm po përdoren dhe për sa kohë nga secili prej shërbimeve/aplikimeve duke përdorur një brez të veçantë. Përdorimi do të përcaktohet nga numri i autorizimeve, instalimeve radio, pajisjeve, (p.sh.: i stacioneve BTS, pajisjeve fundore celulare, ose stacionet e transmetimit TV etj.).

Për vlerësimin e shkallës së përdorimit udhëzohet klasifikimi me nivele: pa përdorim, përdorim i ulët, përdorim i mesëm dhe përdorim i lartë, siç jepet në tabelën më poshtë.

Vlerësimi	0	1	2	3
Vlerësim i përgjithshëm	Pa përdorim	Përdorim i ulët	Përdorim i mesëm	Përdorim i lartë
% e përdorimit të brezit	<30%	30-60%	60-90%	>90%

Kriteri i tendencave të kërkesës

Për planifikimin afatgjatë të spektrit është i nevojshëm vlerësimi i tendencës së kërkesës për përdorimin e spektrit. Vlerësimi i tendencës së kërkesës është një tregues që tregon nëse kërkesa aktuale për një shërbim/aplikim të veçantë është e qëndrueshme ose ka të ngjarë të ndryshojë ndjeshëm në të ardhmen.

Për vlerësimin e tendencës së kërkesës udhëzohet të merren parasysh brezat e frekuencave që janë autorizuar kohët e fundit p.sh. në tre – pesë vitet e fundit, ose nuk janë ende në përdorim por që pritet të kenë përdorim të lartë pasi të jetë aktivizuar shërbimi.

Në lidhje me vlerësimet përkatëse për këtë kriter, udhëzohet klasifikimi i tendencës së kërkesës si më poshtë:

- 0 – Kërkesë në rënie;
- 1 – Kërkesë konstante;
- 2 – Kërkesë e moderuar;
- 3 – Kërkesë e lartë.

Kriteri i shtrirjes gjeografike

Kriteri i shtrirjes gjeografike është një tregues i mbulimit të popullsisë ose mbulimit gjeografik të ofruar (në rastin e rrjeteve që shërbejnë për publikun) ose shtrirjen e territorit kombëtar ku po përdoret burimi i spektrit. Vlerësimi sipas kriterit të shtrirjes gjeografike për rrjetet TV dhe të lëvizshëm duhet të bazohen në nivelet aktuale të mbulimit (popullsi ose territor).

Një shembull për vlerësimet përkatëse sipas kriterit të shtrirjes gjeografike për shërbimet celulare dhe televizione jepet në tabelën e mëposhtme:



Vlerësimi	0	1	2	3
Brezi i maturuar (të vjetër) celular Mbulimi i popullsisë	<80% për të gjitha rrjetet	>80% për të paktën një rrjet	>80% për të gjitha rrjetet	>90% për të gjitha rrjetet
Brezat e rinj celular (caktuar në 5 vitet e fundit) Mbulimi i popullsisë	pa filluar akoma	<50%	50-75%	>75%
Brezi televiziv tokësor Transmetimet digjital/ numerike Mbulimi i popullsisë	<90% për të gjitha MUKSET	>90% për të paktën një MUKS	>90% për të paktën 2 MUKSE	>90% për të gjitha MUKSET

Për shërbimet/aplikimet e tjera, kriteri i vlerësimit do të bëhet në varësi të zonave gjeografike ku janë afruar këto shërbime/aplikime. Më poshtë jepet udhëzimi për klasifikimin në këtë rast:

- 0 - Nuk ka mbulim aktual;
- 1 - Mbulim vetëm në një zonë/rajon;
- 2 - Mbulim në disa zona por e kufizuar në një pjesë të territorit kombëtar;
- 3 - Mbulim në zona të shumta në të gjithë territorin kombëtar.

Për të përmirësuar eficiencën e përdorimit të spektrit rekomandohet të vlerësohet, për aq sa është e mundur, niveli apo mundësitë e bashkëpërdorimit të frekuencës sipas tabelës më poshtë.

Vlerësimi	0	1	2	3
Vlerësimi i përgjithshëm	Nuk ka bashkëpërdorim të frekuencës	Bashkëpërdorim i kufizuar midis dy shërbimeve/aplikimeve	Bashkëpërdorim i zgjeruar midis dy shërbimeve/aplikimeve ose bashkëpërdorim i kufizuar midis tre ose më shumë	Bashkëpërdorim i zgjeruar midis tre ose më shumë shërbimeve/aplikimeve

Në rastet e justifikuara, me qëllim analizimin e mundësive të rritjes së efikasitetit të përdorimit të spektrit, të lidhur me zhvillimet teknologjike, mund të përdoren kriteret e tjera si kriteri i teknologjisë. Kriteri i teknologjisë përdoret si një tregues relativ për vlerësimin e efikasitetit të përdorimit të spektrit, duke parë teknologjitë e përdorura në një brez të caktuar krahasuar me përdorimin apo jo të teknologjive të reja/standardeve më të fundit për shërbimet/aplikimeve në fjalë që mund të çonin në një rritje të efikasitetit.



UDHËZIM

Nr. 1289/1, datë 4.5.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË
REGJISTRIMIT TË MJETEVE
LUNDRUESE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 24, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 9.7.2014, “Për miratimin e rregullores ‘Për regjistrimin e mjeteve lundruese’”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare të jenë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Të ardhurat, që realizohen nga shërbimet të derdhen në llogarinë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, sipas ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij udhëzimi.

Të gjitha aktet që bien në kundërshtim me këtë udhëzim shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Lidhja nr. 1

EMËRTIMI I SHËRBIMIT	TARIFA, LEK	SEKTORI QË I LËSHON
Tarifë e certifikatës së regjistrimit	10000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Regjistrim mjeti pa motor	1500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Regjistrim mjeti me motor	6500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Leje lundrimi	3500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Dëshmi kualifikimi për peshkatarët	900	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Dëshmi kualifikimi për detarët (STCW-78/95)	1600	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Ndryshimi i pronësisë së mjetit	2000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Zgjatje afti i lejes së lundrimit	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare pa motor	500	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare me motor me aftësi lundrimi deri 6 milje nga bregu	2000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Çregjistrimi i mjeteve detare me aftësi lundrimi mbi 6 milje nga bregu	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Pranimi i protestave detare	5000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve
Lëshimi i certifikatës minimumit	1000	Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detareve



URDHËR

Nr. 262, datë 21.6.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 243, DATË 8.6.2021, “PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISËT E HAPURA DHE TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 27, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 243, datë 8.6.2021, bëhen shtesat si vijon:

1. Në pikën 1 togfjalëshi “dhe tregjet e kafshëve të gjalla” shfuqizohet.

2. Pas pikës 1, shtohen pikat si vijon:

“2. Lejimin e tregtimit të shpendëve të gjalla, nga fermat në zonat e lira nga influenza aviare, në treg, të shoqëruara me raport-analizë (PCR) lëshuar nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, që vërteton që shpendët janë të pastër nga Influenca Aviare dhe certifikatë shëndetësore veterinarë lëshuar nga veterineri zyrtar.

3. Lejimin e tregtimit nga ferma në fermë të shpendëve, ferma në zonat e lira, shoqëruar me certifikatë shëndetësore veterinarë, lëshuar nga veterineri zyrtar përkatës.”.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi**

URDHËR

Nr. 263, datë 22.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 44, DATË 26.1.2021, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE SUBJEKTIT FITUES TË PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrata tip bashkëlidhur urdhrin nr. 44, datë 26.1.2021, zëvendësohet me kontratën tip, sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi**



**KONTRATË TIP
PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË
UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E
TJERA TË PESHKIMIT NË DET, PA
PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE
DHE PËR ZHVILLIMIN E
AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE
PUBLIKE TOKËSORE DHE UJORE**

Kjo kontratë lidhet sot, në datën _____, midis palëve si më poshtë:

Ministritë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
(në vijim “MBZHR”), përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm _____, me seli: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë,

dhe

Personit fizik/juridik (në vijim “Subjekti”)

_____, me administrator _____,
me numër NIPTI: _____, me adresë: _____,
mbajtës i kartës së identitetit (ID) me nr. _____.

Baza ligjore: Kjo kontratë lidhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të peshkimit dhe të akuakulturës në momentin e nënshkrimit të saj.

Subjekti është fitues i procedurës konkurruese zhvilluar më datë __. __. ____, sipas plan-biznesit të paraqitur në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, publikuar në Buletinin e APP-së nr. __, datë __. __. ____, vendimi nr. __ datë __. __. ____ i MBZHR-së.

Palët kontraktuese ranë dakord të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje, si më poshtë vijon:

**Neni 1
Objekti i kontratës**

Kjo kontratë ka për qëllim _____
(të vendoset aktiviteti; ushtrimin e së drejtës për peshkim në ujërat e brendshme/ ushtrimin e së drejtës për peshkim në det pa përdorimin e mjeteve lundruese/ zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike ujore dhe tokësore) nga ana e personit fizik/juridik _____, me administrator _____, në objektin ujqor: _____

**Neni 2
Kohëzgjatja e kontratës**

1. Kjo kontratë lidhet për një periudhë _____ dhe sjell efekte nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Me përfundimin e këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur.

3. Përfundimisht, në kontratën me objekt zhvillimin e akuakulturës, Subjekti ka të drejtë të kërkojë rinovimin e kësaj kontrate deri në 3 muaj përpara përfundimit të afatit të kontratës, vetëm nëse ka përmbushur kushtet ligjore të peshkimit dhe akuakulturës.

**Neni 3
Pagesa dhe regjimi i saj**

1. Subjekti do të kryejë pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit ose akuakulturës, në vlerën e përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare, për llogari të Drejtorisë Tatimore, Tiranë (numri i llogarisë pranë Inspektoratit të Peshkimit të qarkut _____, rrethi _____).

2. Pagesa e parë do të kryhet menjëherë, në momentin e nënshkrimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për taksat kombëtare.

3. Pagesat në vitet e tjera do të kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

**Neni 4
Transferimi**

1. Në rast se Subjekti, person fizik, ndërrohet, detyrimet që rrjedhin nga kontrata u kalojnë trashëgimtarëve, pas kërkesës së tyre të MBZHR-së.

2. Kërkesa duhet të bëhet brenda 60 ditëve nga momenti i ngjarjes. Me mbarimin e këtij afati, nëse nuk ka asnjë kërkesë nga trashëgimtarët, kontrata zgjidhet.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e MBZHR-së

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Subjektit, për:

a) fillimin e investimeve brenda afatit ligjor prej 6 muajsh;

b) realizimin e investimeve në vite, sipas treguesve të deklaruar nga ana e tij në plan-biznesin e paraqitur si kërkuar për ushtrim të aktivitetit të ripopullimit të peshkimit;

c) aktverifikimin e investimeve të dokumentuara dhe të plotësuar nga ana e investitorit dhe Subjektit që ushtron aktivitetin;

d) depozitimin rregullisht të deklarimeve statistikore pranë strukturave lokale deri më 31 mars të vitit në vazhdim;

e) respektimin e legjislacionit të peshkimit dhe të akuakulturës në objektin ujor ku do të zhvillohet aktiviteti, si dhe i procedurave të trajtimit të produktit deri në treg.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i garanton Subjektit të drejtën e _____ (të vendoset forma e aktivitetit), brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e së drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë Subjektit, nëpërmjet kësaj kontrate.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Subjektit

1. Subjekti gëzon të drejtën e ushtrimit të së drejtës _____ (të vendoset aktiviteti; ushtrimin e së drejtës për peshkim në ujërat e brendshme/ushtimin e së drejtës për peshkim në det pa përdorimin e mjeteve kundruese/zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike ujore dhe tokësore).

2. Të kryejë pagesën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit dhe të akuakulturës, sipas parashikimeve të nenit 3 të kësaj kontrate.

3. Subjekti nuk ka të drejtë të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjera.

4. Subjekti detyrohet të lejojë dhe të shoqërojë organin kompetent të ngarkuar për inspektim dhe

vëzhguesit/monitorët e MBZHR-së, të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kjo kontratë, si dhe të kryejnë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi.

5. Subjekti zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e peshkimit dhe të akuakulturës, si dhe çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në këtë fushë.

6. Në rast të delegimit të monitorimit të kontratës nga MBZHR-ja tek organi i pushtetit vendor, Subjekti gëzon të drejtat dhe detyrohet të zbatojë të njëjtat kushtet të parashikuara në këtë kontratë.

Neni 7

Pezullimi i kontratës si rezultat i forcës madhore

1. “Forcë madhore” do të quhet çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është tej parashikimit dhe kontrollit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të palës së cenuar, duke i shkaktuar pamundësi të plotë apo të pjesshme palës së cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj, sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave për ushtrimin e aktivitetit).

2. Rastet e forcës madhore përfshijnë:

a) veprimet e luftës, pushtim, terrorizmin, kryengritjet, grevat në vendin e punës, grevat e përgjithshme apo lokale;

b) rrufeja, zjarri, tërmeti, fatkeqësi të tjera natyrore;

c) çdo akt sabotimi, drejtim i keq, krim i organizuar dhe/ose aktivitete pune që imponojnë apo pengojnë zbatimin e saj.

3. Pala e cenuar përjashtohet nga përmbushja e detyrimit për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia objektive për të përmbushur detyrimet.

4. Palët nuk humbasin të drejtën e zbatimit të kësaj kontrate. Për këto arsye detyrimisht përpilohet aneks-kontrata shtesë në të cilën do të përcaktohen edhe afatet e reja kohore të zbatimit të kontratës.

5. Dokumentimi i rastit të forcës madhore pasqyrohet në procesverbal të miratuar për çdo rast dhe në prezencë të organit të ngarkuar nga ligji për inspektimin.



Neni 8

Zgjidhja e kontratës

1. MBZHR-ja ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 2 të kontratës, kur Subjekti:

a) nuk ka shlyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, brenda afateve të përcaktuara;

b) nuk e ka ushtruar të drejtën e peshkimit ose akuakulturës, pa shkaqe të arsyeshme, për një periudhë kohore mbi 6 muaj;

c) kultivon lloje, sasi peshku dhe organizmash të tjerë që nuk janë të përcaktuar në kontratën për zhvillimin e aktivitetit

d) nuk realizon brenda një viti nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate, vlerën e investimit të parashikuar për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit sipas plan-biznesit të paraqitur për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit ose akuakulturës;

e) nuk dorëzon të dhënat statistikore të aktivitetit të kryer, në fund të çdo viti kalendarik ose kur i kërkohet nga MBZHR-ja ose nëse nuk i dorëzon këto të dhëna për 2 vite radhazi për kontratat me objekt zhvillimin e akuakulturës;

f) ka cenuar rëndë mjedisin;

g) me pushimin së ekzistuari/mbarimin e personit fizik/juridik, të cilit i është dhënë e drejta e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit ose akuakulturës, në objektin ujor përkatës;

h) nëse pas nënshkrimit të kontratës, vërtetohet me fakte, se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është dhënë në bazë të të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta;

i) personi fizik ka ndërruar jetë dhe asnjë prej trashëgimtarëve të tij ligjor nuk ka paraqitur kërkesë për kalimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, brenda 60 ditëve;

j) nuk ka respektuar zonën e caktuar për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë kontratë.

2. Në rast se, nga struktura të tjera shtetërore merren vendime me rëndësi strategjike, të cilat bien ndesh me aktivitetin në sipërfaqet objekt kontrate, kontrata e peshkimit/akuakulturës revokohet, pa asnjë detyrim për palët kontraktuese.

3. Kontrata që ka për objekt zhvillimin e akuakulturës zgjidhet sipas nenit 21, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, të ndryshuar.

Neni 9

Modifikimi i kontratës

1. Si rregull i përgjithshëm, modifikime në këtë kontratë nuk lejohen.

2. Në raste të veçanta, kur janë verifikuar implikime të rënda në mjedis apo në rastet e shfaqjes së sëmundjeve që rezultojnë nga përdorimi i pajisjeve të përdorura, të përcaktuara në kontratë, çdo modifikim lejohet vetëm pas miratimit me shkrim nga të dyja palët dhe përpilimit të aneks-kontratës përkatëse shtesë.

Neni 10

Sanksionet

Për çdo konstatim të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës me masën e gjobës dhe/ose me prishjen e kontratës.

Neni 11

Komunikimi

1. Çdo komunikim midis palëve për problemet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të bëhet me shkrim në këto adresa:

a) **Subjekti** _____

Adresa: _____

Adresa *email*/tel./fax: _____

Administratori ose përfaqësuesi: _____

b) **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë

Tel./Fax: 35522667545

Web: www.Bujqesia.gov.al

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 12

Mosmarrëveshjet

1. Kjo Kontratë interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Çdo mosmarrëveshje e lindur, në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, duke arritur në një marrëveshje të pranueshme pa cenuar vlerat, afatet, kushtet teknike, sanksionet dhe gjobat.



2. Në të kundërt palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në territorin brenda të cilit shtrihet objekti ujqor për të cilin Subjekti ka fituar këtë të drejtë.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Neni 14
Të tjera

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga palët në 4 (katër) kopje të barasvlershme, nga të cilat një kopje e mban Subjekti.

Ministria e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural
Sekretari i Përgjithshëm
Administratori

Personi fizik/ juridik
Administratori

URDHËR
Nr. 120, datë 24.6.2021

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
PËR MIRATIMIN, PUBLIKIMIN E
PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
DHE TË REGJISTRIT TË KËRKESAVE
DHE PËRGJIGJEVE TË RISHIKUAR**

Bazuar në nenin 22, pika 3, 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 177, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, te Sekretari i Përgjithshëm, z. Emis Çërava, si nëpunësi më i lartë civil në KLP, sipas klasifikimit

të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

2. Ngarkohet z. Emis Çërava për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË
Gent Ibrahimi**

NJOFTIM
Nr. 7614, datë 22.6.2021

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, mbi ngritjen e një ndërtese modulare për qëllime arsimore, një donacion i Republikës së Sllovenisë për Republikën e Shqipërisë pas tërmetit të nëntorit 2019”, ka hyrë në fuqi më 9 qershor 2021.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi**

VENDIM
Nr. 131, datë 3.6.2021

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR
ME RISHIKIMIN E VENDIMIT
TË ERE-s NR. 61, DATË 25.2.2021**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5; të nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit II.8, pika II.8.4, e Kodit të Matjes, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 101, datë 26.8.2008, “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019; “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të



Bordit të ERE-s, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s; të neneve 15, 16 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 4.5.2021, si dhe relacionin shtesë nr. 67/1-1 prot., të datës 31.5.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021,

konstatoi se:

- Shoqëria OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e kësaj rregulloreje duke përfshirë në të tipologjitë e konstatimeve në terren që nuk janë të parashikuara në rregullore, si më poshtë vijon:

- Ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive;

- Përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive;

- Përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive;

- Përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive;

- Përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë.

- Në zbatim të nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcaktohet si autoriteti përgjegjës për miratimin e “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Gjithashtu, shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 7997 prot., datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e afateve të parashikuara në nenin 10 të rregullores, si më poshtë:

Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a. punon me sistem faturimi me cikël 30-ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose ciklit mujor të lexim/faturimit, si dhe njoftimi i furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkeljen.

- ERE, me vendimin nr. 61, datë 25.2.2021, ka filluar procedurën për miratimin e një ndryshimi në nenin 10, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të

shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, duke përjashtuar pjesën tjetër të kërkesës së OSSH sh.a., për ndryshimin në nenin 2, të kësaj rregulloreje, me arsyetimin që ndryshimet e propozuara në këtë nen nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.

- Në vijim, shoqëria OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 3154 prot., datë 31.3.2021, ka kërkuar dhe një herë rishikimin e fillimit të procedurës për një ndryshim në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, ku së bashku me propozimin për rishikim, në bazë të konstatimeve të bëra në vendimin e ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, ka paraqitur në formë tabelore edhe një panoramë të situatës, lidhur me kategoritë e shkaktuesve të dëmit.

- Gjithashtu, OSSH sh.a., në kërkesën për rishikim thekson se e çmon si të papërshtatshëm përjashtimin e abonentëve në bokse kolektive nga aplikimi i dëmit ekonomik, pasi kjo sjell:

- nxitjen dhe jo frenimin e trendit të ndërhyrjeve/riidhjeve të paligjshme të përdoruesve të rrjetit;

- nuk ndihmon në reduktimin e humbjeve joteknike;

- nuk ndihmon për disiplinimin e sjelljes së përdoruesve të rrjetit.

- Kërkesa e shoqërisë OSSH sh.a., datë 31.3.2021, protokolluar në ERE më datë 3.4.2021, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, “Për fillimin e procedurës për një ndryshim në ‘Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike’”, është depozituar jashtë afatit të parashikuar në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 53, 56 dhe 59, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.



- Sa më sipër, konstatojmë se kërkesa e shoqërisë OSSH sh.a., e paraqitur me shkresën nr. 3154 prot., datë 31.3.2021, protokolluar në ERE më datë 3.4.2021, rezulton përtej afatit prej 7 ditë kalendarike nga data e njoftimit të vendimit nr. 61, datë 25.2.2021, i cili është dërguar me shkresën nr. 443 prot., datë 12.3.2021.

- Nga ana e shoqërisë OSSH sh.a. nuk është parashtruar asnjë provë e re në kërkesën e saj për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, lidhur me fillimin e procedurës për një ndryshim në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, siç parashikuar në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenin 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

- Të dhënat e paraqitura në formë tabelare nuk përbëjnë argument, për shkak se në të gjitha konsultimet e zhvilluara dhe draftet e qarkulluara mes palëve qëndrimi i ERE-s ka qenë i qartë, lidhur me përjashtimin e bokseve kolektive nga aplikimi i dëmit ekonomik për ndërhyrjet në aparatin matës, duke u bazuar te parimi i kufirit të pronësisë, siç përcaktuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s. Gjithashtu, dhe neni II.8.4, i “Kodit të Matjes”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 26.8.2008, përcakton qartë se: “Konsumatorët do të përdorin me kujdes dhe do t'i ruajnë pajisjet e matjes kur ato janë të vendosur brenda kufijve të pronësisë së konsumatorit”.

- Me vendimin nr. 118, datë 4.5.2021, Bordi i ERE-s ka vendosur: “Shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, “Për fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, me 30 ditë”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e OSSH sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 133, datë 7.6.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN MAJ 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur me nr. 87/6 prot., datë 4.6.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi



përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 5698 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin maj 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë

elektrike, për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kWh.

- Sasia e energjisë elektrike të prokuruar në treg të parregulluar është 1,440 mWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s, për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Maj 2021

Maj 2021		Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.256
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	6.44
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh	10.48

Për sa përcaktuar, për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2021, të jetë 10.48 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, prej 10.48 lekë/kWh, për muajin maj 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 134, datë 7.6.2021****MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343,
SERIA F16, PËR FURNIZIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE TË
SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, grema “d”; 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 70/2 prot., datë 10.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe relacionin plotësues nr. 70/2-1 prot., datë 4.6.2021, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, për furnizimin e energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 9.4.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 105, datë 22.4.2021, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 6/12 prot., data 22.4.2021, është bërë publikimi në median e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës së modifikimit të licencës nr. 343, seria F16, dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 7.5.2021) nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- Shoqëria, me shkresën nr. 540/1 prot., datë 27.4.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për të cilin që në aplikimin e saj kishte deklaruar se do ta dorëzonte në ERE sapo ta dispononte.

- Në mbledhjen e Bordit, të datës 17.5.2021, Bordi i ERE-s vendosi të shtyjë vendimmarrjen për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për arsye se nevojitej kryerja e disa plotësimeve, në lidhje me: Deklaratën për veprimtaritë që kryen shoqëria; Strukturën e organizimit të shoqërisë; Mbajtjen e llogarive të ndara për veprimtaritë e licencuara; Kontratën e qirasë për disponimin e zyrave.

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën nr. 540/4 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur në ERE sa kërkuar më sipër.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në fazën përfundimtare të procedurës, në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 10.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 135, datë 7.6.2021****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA
INTERNATIONAL DEVELOPMENT”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/4 prot., datë 4.6.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Tirana International Development’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana International Development” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Tirana International Development” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “c”, plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a”, vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE edhe vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, pasi vërtetimi i depozituar nuk ka të dhëna mbi tatimet;

- germa “b”, bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria në vijim duhet të përcjellë në ERE, në një format të lexueshëm, pasqyrat financiare të periudhave 2018 dhe 2020, dhe gjithashtu të audituara pasqyrat për të tri vitet (2018, 2019 dhe 2020), pasi referuar vlerës totale të aktiveve, si dhe të ardhurave nga veprimtaria ekonomike, rezulton se është subjekt i ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar;

- germa “c”, dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letren për mbështetje financiare nga OTP Bank në gjuhën shqipe dhe gjithashtu të shoqëruar me dokumentacion mbështetës financiar, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores, ku të shprehen qartë vlerat monetare për këtë financim;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8,



- germa “b”, Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, të specifikuar kapitalin financiar që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 136, datë 7.6.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFO- TELECOM” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin,

rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/5 prot., datë 4.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Shoqëria “Info-Telecom” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 713 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave, për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Info-Telecom” sh.p.k., rezulton se subjekti ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: “a” dhe “c”, plotësuar.

- Dokumentacioni që mbetet ende pa u plotësuar tërësisht konsiston në:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a”, vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijura vërtetim që nuk ka detyrime).

Shoqëria ka depozituar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore, por në zbatim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, duhet të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8,



germa “b”, kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.

Shoqëria duhet të specifikojë kapitalin që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta depozitojë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Info-Telecom” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 137, datë 7.6.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 478, SERIA T20, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 242, DATË 21.12.2020, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “a”, të nenit 6 dhe nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë

18.4.2017; të nenit 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 5.1, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 87/1 prot., datë 3.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, Bordi i ERE-s vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.;

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gwh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Në vijim të këtij licencimi me kusht, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 1, germa “i”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2020, si dhe ka paraqitur kërkesën për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të mbetur ende pa plotësuar.

- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe në kërkesën e saj, me vendimin nr. 107, datë 22.4.2021, Bordi i ERE-s ka vendosur që shoqëria të depozitojë në ERE, brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021, dokumentacionin si më poshtë:



i. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

ii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gwh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iii. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 107/2021, me shkresën nr. 451/3 prot., datë 4.5.2021 dhe me shkresën nr. 451/4 prot., datë 18.5.2021, i ka rikujtuar asaj afatin për plotësimin e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të vendimit të Bordit nr. 107/2021, duke sjellë në vëmendje se mosplotësimi i dokumentacionit brenda datës 26.5.2021, do të përbëjë kusht për rishikimin e vendimit.

- Nuk rezulton që shoqëria të ketë kthyer përgjigje ndaj shkresave të ERE-s.

- Nga analiza e kryer rezulton se shoqëria nuk ka përmbushur brenda afatit kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit e po ashtu nuk ka dokumentuar në ERE përpjekjet e saj për përmbushjen e tyre.

- Në zbatim të nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, shoqëria ka të drejtë të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e fillimit të kësaj procedure.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 478, seria T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, të ndryshuar.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 138, datë 7.6.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN DHE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 109, DATË 29.6.2016, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar; të nenit 15, 19 dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 22, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/2 prot., datë 3.6.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 1, datë 7.1.2021, ndryshuar me urdhrin nr. 01/1, datë 28.5.2021,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i ERE-s ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin,



rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Më tej, me vendimin nr. 215, datë 20.12.2019, janë miratuar disa ndryshime në rregulloren e sipërcituar.

- Ndryshimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht me ligjin nr. 61/2020, datë 14.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109, datë 9.6.2020, nuk afektojnë përcaktimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në nenin 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është përcaktuar se ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

- Ndryshimet e propozuara në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, janë të nevojshme në kuadër të përmirësimit të saj, si edhe janë bërë specifikimet në lidhje me mënyrën e pagesave të aplikimit, në përputhje me ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar.

- Po ashtu ndryshon dhe aneksi A, i cili tashmë është konceptuar si një format që plotësohet nga vetë aplikuesi, i cili duhet të plotësojë emrin e subjektit, NUIS-in, llojin e aplikimit dhe llojin e veprimtarisë, nënshkruhet në fund dhe depozitohet në ERE, me qëllim plotësimin elektronikisht të faturës përkatëse.

- Në aneksin A, janë bërë unifikime pagesash për disa nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, duke u bazuar te fakti që procedura dhe volumi i dokumentacionit që shqyrtohet deri në miratimin e licencimit është e njëjtë. Pagesa për ndjekjen e procedurës së modifikimit të një licence vlerësohet të jetë sa $\frac{1}{2}$ e vlerës së pagesës për licencimin në të njëjtën veprimtari. Po ashtu, vlerësohet se duhet unifikuar dhe pagesa për ndjekjen e një procedure njohje licence, për veprimtarinë e furnizimit dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike.

- Përveç sa më sipër, në aneksin A, shtohet dhe një zë i ri, që është pagesa për lëshim dublikatë të licencës. Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës, ai mund të bëjë një kërkesë në ERE për lëshim dublikatë licence, kundrejt pagesës prej 15 000 lekësh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, (ndryshimet e propozuara gjenden bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 139, datë 15.6.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“GREEN TECH” SHPK PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 115,
DATË 26.4.2021, “MBI PËRCAKTIMIN E
ÇMITIT TË BLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA
BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME NGA ERA,
PËR VITIN 2020”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 144, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e datës 15.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 89/3 prot., datë 11.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Tech’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 115, datë 26.4.2021, ‘Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, për vitin 2020’”,

konstatoi se:

- Në vendimin nr. 115, datë 26.4.2021, Bordi i ERE-s, është shprehur për:

1. Miratimin e çmimit të mesatarizuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw, prej 75.64 euro/mwh, për vitin 2020.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

- Më datë 18.5.2021, në ERE është paraqitur shkresa e protokolluar me nr. 671 prot., e shoqërisë “Green Tech” sh.p.k., me anë të së cilës kjo shoqëri i është drejtuar ERE-s me kërkesë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 115/2021.

- Në këtë vendimarrje të Bordit të ERE-s është parashikuar se: “ky vendim hyn në fuqi menjëherë”. “Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike”.

- Subjekti kërkuar është njohur me përmbajtjen e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 115/2021, përmes faqes zyrtare të ERE-s në internet, më datë 18.5.2021, si dhe është njoftuar zyrtarisht me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 695 prot., datë 24.5.2021.

- Në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet:

Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, përcaktohet si vijon:

1. Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Në kuptim të parashikimeve të nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kërkuar legjitimohen si palë në këtë procedurë për shkak të interesit të drejtpërdrejtë në këtë vendimarrje.

- Për sa i përket afateve të parashikuara në dispozitat e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, rezulton se kërkesa e shoqërisë për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s është paraqitur brenda këtyre afateve, referuar marrjes në dijeni përmes faqes zyrtare të ERE-s në internet dhe njoftimit zyrtar si më lartë konstatuar.

- Kërkesa për rishikim është përcjellë në cilësinë e provës së re, dhe si e tillë duhet të çojë ERE-n drejt marrjes së një vendimi të ndryshëm, në lidhje me parashikimet e kësaj dispozite.

- Ashtu sikurse është konstatuar dhe arsyetuar në vendimin e ERE-s, objekt i kërkesës për rishikim, në kontratën mes MIE-s dhe shoqërisë



“Green Tech” sh.p.k., neni 8, pika 2 dhe neni 10, pika 3, është parashikuar se vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik si dhe MIE-s, bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimin e veprës, lëshon certifikatën e pranimit të veprës e cila do të përmbajë të dhëna reale tekniko-ekonomike të centraleve prodhuese, në mbështetje të udhëzimit nr. 5, datë 13.10.2020, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për miratimin e procedurave për lëshimin, transferimin, modifikimin ose anulimin e ‘Certifikatës së pranimit të veprës’ për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga impiantet që përdorin energjinë nga burime të rinovueshme”.

- Dispozita e parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 115/2021, në asnjë rrethanë nuk synon/tenton të cenojë të drejtën e garantuar të subjektit kërkuar që ky çmim të jetë i pandryshuar për 15 vitet në vijim, por nisur nga fakti që në Shqipëri aktualisht eksperiencia dhe të dhënat, në lidhje me ecurinë e investimit në këtë lloj teknologjie të prodhimit të energjisë elektrike, mungojnë, ERE ka vlerësuar se në rast se aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Kontrata koncensionare e lidhur mes palëve dhe autoritetit shtetëror, e cila është baza ligjore që legjitimon të drejtën e kërkuar për të disponuar mbi të drejtën e shitjes së energjisë së prodhuar, referuar nenit 8, pika 2 dhe nenit 10, pika 3, mund të pësojë ndryshime), mund të ndryshojnë, ky vendim dhe vetë çmimi i përcaktuar janë objekt rishikimi, por pa përkeqësuar pozitën apo cenuar parimin e sigurisë juridike për palët e interesit.

- Dispozitat e neneve 144 e në vijim, në “Kodin e Procedurave Administrative”, lidhen me situatën kur palët e interesit kërkojnë anulimin ose ndryshimin e një akti administrativ me justifikimin se ai/ajo, nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rrethana specifike apo prova të reja me shkresë brenda procedurës administrative. Nëse mund të ishin paraqitur prova me shkresë ose rrethana të tjera nga pala në procedurën administrative ose në procedurën e ankimit, çka rezulton se pala nuk e ka bërë këtë, atëherë nuk është e pranueshme të kërkohej rishikim, në mënyrë që organi publik të rihapë procedurën administrative dhe të lejohet të

marrë vendim të ri mbi rastin. Parakusht i rishikimit është që pala nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rrethana apo prova me shkresë ose të veçanta brenda procedurës administrative ose procedurës së ankimit.

- “Provat e reja”, në kuptim të “Kodit të Procedurës Administrative” janë vetëm dokumente në formë të shkruar, të cilat janë të përshtatshme për të provuar pretendimet e palëve, lidhur me fakte të rëndësishme të deklaruara nga pala në procedurën hetimore. Vetëm provat me shkresë mund të çojnë në rishikim. Edhe rrethanat në kuptim të parashikimeve të “Kodit të Procedurës Administrative”, nuk duhet të jenë “të reja”, por të zbulohen ose të mësohen rishtazi nga pala. Parakusht është që rrethanat të kenë ekzistuar tashmë në kohën kur është zhvilluar procedura administrative por nuk kanë qenë të njohura për palën dhe, prandaj, nuk janë paraqitur në organin publik.

- Në lidhje me sa më sipër, nuk rezulton të jetë e provuar as shkresërisht e as nëpërmjet shpjegimeve në lidhje me rrethanat e konstatuara pas vendimmarrjes së ERE-s, asnjë shkak ligjor që i vlerësuar në cilësinë e provës të çojë ERE-n në ndryshimin e vendimit objekt i kërkesës për rishikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Green Tech” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 115, datë 26.4.2021, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era, për vitin 2020”, si të pa mbështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE-s në rishikimin e tij.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 140, datë 15.6.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR
DEROGIM TË SHOQËRISË “KALISI
HYDROPOWER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Kodit të Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 186, datë 10.11.2017; të neneve 14, 60 dhe 61, pika 1, të “Kodi të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; “Kritereve për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 12.5.2020, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 89/4 prot, datë 14.6.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi “Shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k., për derogim”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., me shkresën nr. 24 prot., datë 17.5.2021, ka parashtruar në ERE kërkesën për derogim bazuar në kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 85, datë 12.5.2020, të Bordit të ERE-s, si dhe dokumentacionet përkatëse për sa kërkuar në kriteret dhe formatin e aplikimit të miratuara me këtë vendim.

- Në të njëjtën kohë, shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 75 prot., datë 27.5.2021, ka dërguar informacion shtesë lidhur me derogimin e kërkuar.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., me numër NIPT: L81818009A, është zotëruese e HEC “Veleshnica 1 & 2”, licencuar në ERE me vendimin e Bordit nr. 71, datë 22.4.2020, duke u pajisur kështu me licencën për prodhimin e energjisë elektrike seria P20, dhe numër licence 465 dhe sipas parashikimeve ligjore në fuqi, legjitimohet për të kërkuar derogim.

- HEC “Veleshnica 1 & 2”, në zbatim të kontratës me autoritetet shtetërore po realizon projektet në lumin e Veleshnicës. Zona ku po ndërtohet HEC “Veleshnica 1” i përket Bashkisë Dibër, ndërsa HEC “Veleshnica 2” i përket dhe pjesërisht Bashkisë Kukës.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka nënshkruar marrëveshjen e lidhjes me OST sh.a., me nr. 531 prot., datë 18.1.2019, për lidhjen me rrjetin e transmetimit 110 kV të HEC “Veleshnica 1 dhe 2”.

- Kërkesa për derogim nga ana e shoqërisë kërkohet për faktin se parashikimi i realizimit të traktit 110 kV të linjës dhe trakti 110 kV të transformatorit ngritës 110/20/6.3 kV pranë HEC “Veleshnica 1” mund të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme primare në dy faza implementimi. Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një periudhë 24-mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

- Realizimi i këtij projekti me dy faza, siç përmendur më sipër, vjen për faktin se lidhja me rrjetin e HEC “Veleshnica 2” kryhet nëpërmjet NST 110/20 kV pranë HEC “Veleshnica 1”, i cili lidhet me rrjetin e transmetimit nëpërmjet një nënstacioni 110/20/6.3 kV, pranë HEC “Veleshnica 1”, me fuqi transformatori 20 MVA dhe një linjë elektrike ajrore 110 kV me dy qarqe rreth 250 metër të gjatë dhe me përcjellës ACSR-240 mm², duke çarë linjën 110 kV Peshkopi – Lapaj.

- Në kushtet që ka përfunduar ndërtimi i HEC “Veleshnica 2”, dhe siç deklaroi vetë subjekti, i pamundësohet vënia në operim e HEC për shkakë objektive dhe forca madhore siç është pandemia COVID-19, pasi skema e lidhjes për dy HEC është e tillë që HEC “Veleshnica 2” kushtëzohet nga mënyra e lidhjes së HEC “Veleshnica 1”, me rrjetin 110 kV.

- Në nenin 35 (kushtet dhe kërkesat teknike për pajisjet e lidhjes së re apo të modifikimit), të “Kodit të Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 4.6.2018, në pikën 3, germa “b”, përcaktohet se: “Lidhjet ndërmjet instalimeve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit dhe rrjetit të sistemit të transmetimit duhet të realizohen nëpërmjet çelësave të fuqisë të aftë për t’u çkycur



me veprim të shpejtë, sipas kërkesave dhe standardeve në sistemet elektroenergjetike”.

- Në këto kushte, realizimi i traktit 110 kV të linjës dhe trakti 110 kV të transformatorit ngritës me dy faza kërkon derogimin/pezullimin e përkohshëm të nenit 35, pika 3, germa “b”, sipërcituar. Kjo pikë, vetëm për këtë rast, do të jetë në zbatim të shkallëzuar me dy faza. Faza e parë për një afat 24-mujor, trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse dhe në përfundim të këtij afati trakti 110 kV të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

- Në këto kushte, OST sh.a. dhe shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. duhet të marrin masat e nevojshme teknike për të garantuar sigurinë e operimit të veprës dhe të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 667/2 prot., datë 28.5.2021, i është drejtuar OST sh.a. lidhur me kërkesën e bërë nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. për derogim nga Kodi i Transmetimit, për mënyrën e lidhjes së HEC “Veleshnica 2” në linjën elektrike 110 kV Peshkopi – Lapaj.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 3465/1 prot., datë 9.6.2021, nuk ka paraqitur kundërshtim për dhënien e derogimit për shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. duhet të marrë në konsideratë dhe të miratojë pranë OST sh.a., dy projektet e zbatimit (për fazën e parë sipas skemës së propozuar për derogim dhe në fazën finale sipas skemës pas derogimit 24-mujor).

- Në pikën 4.5.1, të “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, është përcaktuar se: “Në të gjitha rastet kostot për lidhjen ose modifikimin e saj me rrjetin e transmetimit përballohen nga aplikuesi”.

- Në zbatim të rregullores, sipërcituar, në marrëveshjen e lidhjes me OST sh.a., respektivisht në nenin 6, është përcaktuar se jo vetëm punimet do të kryhen nga investitori, por përdoruesi me shpenzimet e tij do të ruajë të vlefshme përgjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje të gjitha autorizimet e nevojshme me qëllim mirëfunksionimin e aseteve të lidhjes.

- Bazuar në sa përcaktuar në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit” dhe

marrëveshjen e lidhjes me OST sh.a., të gjitha kostot për realizimin e lidhjes së HEC do të mbulohen nga aplikanti, shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k.

- Kërkesa për derogim e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. është publikuar në faqen e internetit të ERE-s, në zërin “Konsultime”, në datën 25.5.2021, në mënyrë që të sigurohet transparenca e duhur për këtë proces dhe t’i jepet mundësia palëve të treta për ndonjë opinion apo koment të mundshëm, por deri më tani nuk rezulton ndonjë opinion apo koment nga këto të fundit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë derogimin e kërkuar nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k., si vijon:

a) Objekti i derogimit: Realizimi i traktit 110 kV të linjës dhe të transformatorit ngritës që parashikohet të instalohet në nënstacionin 110/20/6.3 kV, pranë HEC “Veleshnica 1” në dy faza implementimi. Në fazën e parë parashikohet që trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse për një periudhë 24-mujore dhe pas kësaj periudhe të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

b) Derogimin/pezullimin e përkohshëm të pikës 3/b, të nenit 35, të Kodit të Transmetimit. Kjo pikë vetëm për këtë rast do të jetë në zbatim të shkallëzuar me dy faza. Faza e parë, për një afat 24-mujor trakti 110 kV të jetë i pajisur me thikë ndarëse dhe në përfundim të këtij afati, trakti 110 kV të pajiset me të gjithë elementet e nevojshme thikë dhe çelës.

c) Afati i derogimit për një periudhë 24 muaj.

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve të njoftojë aplikuesin dhe shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 142, datë 15.6.2021****MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE
RREGULLATORE PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, të nenit 20, germa “d”, nenit 35, pika 1, nenit 45 dhe 46, nenit 51, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, nenit 30, pika 3, nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 5, pika 5.2, 5.3 dhe 5.4, nenit 6, pika 6.1, 6.1.1 (germat: “a”, “b” dhe “c”), 6.2, 6.3 dhe 6.4, të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020; të nenit 15, 16 dhe 17, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 4.11.2020, “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020”; të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2020, “Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore, për vitin 2020, për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 89/2 prot, datë 11.6.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi “Llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2021”,

konstatoi se:

- ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, rezultojnë 304 të licencuar nga ERE (deri në fund të vitit 2020), të cilët janë subjekt i pagesave rregullatore për vitin 2021.

- ERE, me shkresën nr. 349 prot., datë 12.2.2021, ka kërkuar informacion prej të licencuarve mbi deklarin e të ardhurave për aktivitetet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Gjithashtu, të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror janë njoftuar për detyrimin ligjor që ata kanë për të paraqitur pranë ERE-s, pasqyrat e

plota financiare për çdo vit ushtrimor, brenda datës 31 janar të vitit pasardhës ushtrimor.

- Në vijim, me shkresën nr. 385 prot., datë 22.2.2021, ERE ka njoftuar të licencuarit për aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike mbi detyrimin që ka çdo i licencuar të raportojë në ERE çdo muaj, në lidhje me veprimtaritë e licencuara, si dhe dorëzimin pranë ERE-s të raportit vjetor, lidhur me operimet e kryera gjatë vitit 2020.

- Pagesa rregullatore për vitin 2021, është përllogaritur mbështetur në përcaktimet e pikës 5.3, të nenit 5 dhe pikave 6.1, 6.1.1, germa “a”, “b” dhe “c”, 6.2, 6.3 dhe 6.4, të nenit 6, të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, të Bordit të ERE-s.

- Për shoqëritë e licencuara që disponojnë më shumë se një licencë, të cilët nuk i kanë paraqitur pasqyrat financiare të ndara sipas aktiviteteve të licencuara për ndarjen e llogarive, në zbatim të përcaktimeve të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe pikës 3, të nenit 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, pagesa rregullatore për vitin 2021 është llogaritur nëpërmjet peshës specifike të të ardhurave të deklaruara ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë, për një nga licencat, ndërsa, për aktivitetet e tjera të licencuara, është zbatuar automatikisht tarifa fikse e përcaktuar në pikën 6.3, të nenit 6, të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, të Bordit të ERE-s.

- Për të licencuarit të cilët nuk kanë depozituar në ERE të dhëna mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licencuar apo nuk janë gjetur të dhëna mbështetur në përcaktimet e pikës 6.4, të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, të Bordit të ERE-s, është konsideruar pagesa rregullatore e vitit 2020.

- Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të vendimit nr. 258, datë 21.12.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore për vitin 2020, për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë”, janë përllogaritur dhe janë alokuar në llogaritjen e pagesës rregullatore të vitit 2021 të gjitha diferencat të të gjithë të licencuarit e sektorit



të energjisë që nuk kanë qenë subjekt i këtij vendimi, për efekt të buxhetit të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 22, datë 30.1.2020, të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2021, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2020, të konsiderohen në llogaritjen e pagesave rregullatore të periudhës pasardhëse.

3. Të licencuarit, subjekt i këtij vendimi (sipas tabelës bashkëlidhur), duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, në të kundërt, do të jenë subjekt i aplikimit të masave administrative të parashikuara në nenin 42, pika 1, germa “ç”, pika 2, germa “b” dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 27, pika 1, germa “ç” dhe nenit 106, germa “a” (xi), e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, të “Rregullores për procedurat e vendosjes

dhe reduktimit të gjobave” miratuar me vendimin nr. 125, datë 29.7.2016, të Bordit të ERE-s.

4. Për të licencuarit, për të cilët pagesa rregullatore për vitin aktual është pezulluar, nëse do të ndryshojnë rrethanat ligjore, që çuan në pezullim, ky vendim do të jetë objekt rishikimi sa i përket përllogaritjes së pagesave rregullatore që do të rezultojnë.

5. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare, për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2021
1	“KESH” sha	15,540,864
2	“Kurum International” sh.a.	3,032,551
3	“Termocentrali Vlorë” sh.a	100,000
4	“EMIKEL 2003” sh.p.k	77,974
5	“Albania Green Energy” sh.p.k	619,335
6	“Balkan Green Energy” sh.p.k	1,084,906
7	“Spahiu Gjanç” sh.p.k.	91,321
8	“Wonder Power” sh.a	95,831
9	“Ama” sh.p.k	41,424
10	“Hidro Invest 1” sh.p.k	415,498
11	“PURE ENERGY STEBLEVA” sh.p.k	44,885
12	“Malido-Energji” sh.p.k	53,713
13	“Teodori 2003” sh.p.k	190,756
14	“Energji Ashta” shpk	4,390,011
15	“HIDROALBANIA Energji” sh.p.k	778,362
16	“Power Elektrik Slabinje” sh.p.k	588,275
17	“HEC Bishnica 1.2” sh.p.k	182,604
18	“C & S Construction Energy” sh.p.k	644,186
19	“Hydro Energy” sh.p.k	307,196
20	“Wenerg” sh.p.k	250,473
21	“Dishnica Energy” sh.p.k	9,038
22	“ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k	8,676
23	“Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k	257,883
24	“Ansara Koncension” sh.p.k	4,914
25	“Energy Plus” sh.p.k	895,188
26	“HEC Vluse” sh.p.k	554,106
27	“ENERGY PARTNERS -AL” sh.p.k	267,109
28	“Korkis 2009” sh.p.k	3,465
29	“Ferar Energy” sh.p.k	100,000
30	“HEC-i Dragostunje” sh.p.k	208,879
31	“HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k	242,085
32	“Hidropower Elektrik” sh.p.k	348,585
33	“Bekim Energjitik” sh.p.k	70,248
34	“SELISHTE” sh.p.k	100,282
35	“ERMA MP” sh.p.k	164,995
36	“DITEKO” sh.p.k	2,234,319
37	“Idro Energia Pulita” sh.p.k	132,624
38	“Dosku Energy” sh.p.k	61,872
39	“SNOW ENERGY” sh.p.k	76,846
40	“Stravaj Energji” sh.p.k	196,871
41	“Peshku Picar 1” sh.p.k	9,015
42	“HYDRO - SALILLARI” sh.p.k	49,734
43	“Albanian Power” sh.p.k	287,787
44	“Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k	169,372
45	“Henz Energy” sh.p.k	455,434
46	“HYDROBORSH” sh.p.k	170,504
47	“Lu & Co Eco Energy 2011” sh.p.k	15,290
48	“Gjo.Spa.POWER” sh.p.k	994,185
49	“Erdat Lura” shpk	661,191
50	“E.T.H-H” shpk	89,322



I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2021
51	"REJ ENERGY" shpk	282,306
52	"Caushi Energi" shpk	53,510
53	"SA-GLE.Kompani" shpk	60,997
54	"Energi Xhaci" shpk	6,637
55	"TRUEN" shpk	110,833
56	"DUKA T2" shpk	58,628
57	"Tucep" shpk	68,610
58	"HEC-Treske" shpk	256,085
59	"Hidro Energy Sotire" shpk	81,295
60	"Shutina energi" shpk	69,216
61	"HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k	100,000
62	"Zall Herr Energi 2011" shpk	107,329
63	"HEC Qarr & Kaltan" shpk	86,858
64	"Bardhgjana" shpk	82,372
65	"Gjoka Konstruktion Energi" shpk	84,236
66	"Saroll" sh.p.k	30,338
67	"EN.KU" sh.p.k	100,000
68	"Maksi Elektrik" sh.p.k	16,221
69	"Juana" sh.p.k	22,232
70	"WTS Energi" sh.p.k	2,199
71	"Marjakaj" sh.p.k	36,984
72	"Favina 1" sh.p.k	302,552
73	"Selca Energi" sh.p.k	90,833
74	"DN & NAT ENERGI" shpk	36,324
75	"Energo – Sas" shpk	520,067
76	"HEC i Tervolit" shpk	554,536
77	"M.T.C Energy" shpk	123,419
78	"EnRel Hydro" shpk	89,073
79	"Gurshpat Energy" shpk	151,354
80	"Bistrica 3 Energy" shpk	171,801
81	"GJURR REÇ" shpk	235,307
82	"SA'GA-MAT" shpk	141,266
83	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.	139,259
84	"Fatlum" shpk	7,619
85	"KOXHERRI ENERGY" sh.p.k	28,572
86	"Euron Energy" sh.p.k	987,613
87	"Alb-Energy" sh.p.k	1,258,221
88	"Energal" sh.p.k	348,809
89	"Kisi-Bio-Energi" sh.p.k	114,979
90	"HEC Lanabregas" sh.a	698,298
91	"Gama Energy" sh.p.k	154,446
92	"HEC Kabash Porocan" sh.p.k	231,930
93	"Lengarica & Energy" sh.p.k	373,428
94	"Mesopotam Energy" sh.p.k	62,139
95	"Denas Power" sh.p.k	591,498
96	"Strelca Energy" sh.p.k	311,276
97	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	88,540
98	"C & S ENERGY" sh.p.k	681,633
99	"Nishova Energy" sh.p.k	22,579
100	Perparimi SK sh.p.k	23,084



I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2021
101	Dragobia Energy sh.p.k	100,000
102	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	56,281
103	HEC Lashkiza sh.p.k	68,325
104	Liria Energji sh.p.k	210,377
105	Devoll Hydropower sh.a	5,424,024
106	Reka Energy sh.p.k	100,000
107	Gavran Energy sh.p.k	95,297
108	Prell Energy sh.p.k	621,777
109	Xhengo Energji sh.p.k	168,340
110	DAAB Energy Group sh.p.k	74,634
111	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	511,294
112	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k	93,343
113	"SKATINË - HEC" sh.p.k	65,544
114	"Ayen As Energji" sh.a	178,103
115	"EUROBIZNES" sh.p.k	9,343
116	"THE BLUE STAR" sh.p.k	67,292
117	"AFRIMI K" sh.p.k	122,082
118	"SIMA-COM" sh.p.k	99,543
119	"HEC LLËNGË" sh.p.k	131,128
120	"ALESIO – 2014" sh.p.k.,	100,000
121	"LUÇENTE - KONÇESIONARE" sh.p.k	833
122	"Hydro Seta" sh.p.k	602,630
123	"Favina 1" sh.p.k	100,000
124	"DOMI TEC" sh.p.k.	100,000
125	"BLAC ENERGY" sh.p.k	22,439
126	"DERBI – E" sh.p.k.	37,618
127	"EDIANI" sh.p.k.	38,117
128	"ALESIO – 2014" sh.p.k.,	100,000
129	"OSOJA HPP" sh.p.k.	144,429
130	"S G D ENERGJI" sh.p.k.	25,047
131	"SANG 1" sh.p.k	100,000
132	"SPE GJADËR" sh.p.k	100,000
133	"BE-IS ENERGY" sh.p.k	100,000
134	"TRARBA ENERGJI" sh.p.k	100,000
135	"ELVA 2001" sh.a.	2,183
136	"ARSTI" sh.p.k	100,000
137	"HYDRO POWER PANARIT" sh.p.k	16,311
138	"KROI MBRET" sh.p.k	100,000
139	"ERA HYDRO" sh.p.k	16,222
140	"GEGA - G" sh.p.k.	21,862
141	"KALISI HYDROPOWER" sh.p.k.	100,000
142	SEKA HYDROPOWER sh.p.k	694
143	"MATEO & CO" sh.p.k.	100,000
144	"TIRANA ENERGJI" sh.p.k	100,000
145	"KOKA & ERGI ENERGY STAVEC"	100,000
146	"IDI 2005" sh.p.k	25,117
147	"ERDY ENERGY" sh.p.k.	100,000
148	"HEC ZALL XHUXHË" sh.p.k.	100,000
149	"UKKO"sha (Ujsjell.Kanal.Korçë) (PV)	100,000
150	"AGE SUNPOWER" sh.p.k (PV)	154,180



I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2021
151	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k (PV)	155,305
152	"SEMAN1SOLAR" sh.p.k. (PV)	151,839
153	"SEMAN2SUN" sh.p.k (PV)	160,548
154	"SONNE" sh.p.k (PV)	163,581
155	"AED SOLAR" sh.p.k (PV)	163,348
156	"AEE" sh.p.k. (PV)	151,299
157	"RTS" sh.p.k. (PV)	74,726
158	"SMART WATT" sh.p.k (PV)	8,802
159	"ES 2019" sh.p.k	9,012
160	"Statkraft Renewables Albania" sh.a	100,000
160	Total I	59,770,194
II	Liçensë për ndërtim, instalim dhe prodhim	Total pagesa rregullatore 2021
1	"Muso HEC Qyteze" sh.p.k	40,614
2	"Remi" sh.p.k	170,063
3	"E-Vento srl Albania" sh.p.k	100,000
4	"Hera" sh.p.k	100,000
5	"Biopower Green Energy" sh.p.k	100,000
5	Total II	510,677
III	Liçensë për transmetim të energjisë elektrike/gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
1	OST sh.a	20,161,094
2	TAP AG Albania sh.p.k	100,000
3	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)	3,362
3	Total III	20,264,457
IV	Liçensë për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
1	"Operatori I Sistemit te Shperndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.)	79,396,924
2	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)	100,000
2	Total IV	79,496,924
V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
1	"FSHU" sh.a	25,489,867
2	"Alpiq Energy Albania" sh.p.k	100,000
3	"GEN-I Tirana" sh.p.k	58,838
4	"GSA" sh.p.k (Energji Elektrike)	29,357
5	"Kurum International" sh.a	100,000
6	"Ayen Energy Trading" sh.a	105,860
7	"Devoll Hydropower" sh.a	100,000
8	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	938,969
9	"Energy Supply" sh.p.k	100,000
10	"Lengarica & Energy" sh.p.k	100,000
11	"Energia Gas and Power Albania" sh.p.k	99,250
12	Dragobia Energy shpk	100,000
13	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	100,000
14	Xhengo Energji sh.p.k	100,000
15	"Grid Energy" sh.p.k	100,000
16	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k	100,000
17	"ALBANIAN GREEN ENERGY" sh.p.k	100,000
18	"ALBPETROL" sh.a	100,000
19	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k	100,000
20	"Energji Ashta" sh.p.k	100,000



V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
21	“WIND POWER” sh.p.k	100,000
22	“Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a (FTL sh.a)	55,559
23	“ENER TRADE” sh.p.k	100,000
24	“ReENERGY Trading Group” sh.p.k	100,000
25	“KESH” sh.a	100,000
26	“EZ-5 ENERGY” sh.p.k	325,036
27	“AYEN AS ENERGJI” sh.a	4,614,227
27	Total V	33,516,962
-		
VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
1	“Gen – I Tirana” sh.p.k	322,499
2	“KESH” sh.a	979,324
3	“Wonder Power” sh.a	100,000
4	“HYDRO ENERGY” sh.p.k	100,000
5	“Energy Partner Al” sh.p.k	100,000
6	“YLLIAD” sh.p.k	100,000
7	“ENERGY PLUS” sh.p.k	100,000
8	“Hec Vluse” sh.p.k	100,000
9	“Hec Dragoshtunje” sh.p.k	100,000
10	“HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k	100,000
11	“GSA” sh.p.k	708,368
12	“Erma M.P” sh.p.k	100,000
13	“DITEKO” sh.p.k	100,000
14	“Hec Lanabregas” sh.a	100,000
15	“Kurum International” sh.a	100,000
16	“Malido Energji” sh.p.k	100,000
17	“SNOW ENERGY” sh.p.k	100,000
18	“Stravaj Energji” sh.p.k	100,000
19	“Hydro Salillari Energy” sh.p.k	100,000
20	“ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k	88
21	“Albanian Power” sh.p.k	100,000
22	“Albanian Green Energy” sh.p.k	100,000
23	“Balkan Green Energy” sh.p.k	100,000
24	“Henz Energy” sh.p.k	100,000
25	“Energji Ashta” sh.p.k	100,000
26	“Erdat Lura” sh.p.k	100,000
27	“Rej Energji” sh.p.k	100,000
28	“Danske Commodities Albania” sh.p.k	114,661
29	“WENERG” sh.a	100,000
30	“TRUEN” sh.p.k	100,000



VI	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
31	"Shutina Energji" sh.p.k	100,000
32	"Zall Herr energy 2001" sh.p.k	100,000
33	"Gjoka Konstruksion-Energji" sh.p.k	100,000
34	"Spahiu Gjanc" sh.p.k	100,000
35	"M.T.C Energy" sh.p.k	100,000
36	"Ayen Energy Trading" sh.a	209,885
37	"EnRel Hydro" sh.p.k	100,000
38	"Gjurr Rec" sh.p.k	100,000
39	"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	100,000
40	"Emikel" sh.p.k	100,000
41	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.	100,000
42	"Energia Gas and Power Albania" sh.p.k	100,085
43	"Noa Energy Trade" sh.p.k	183,183
44	"Power Elektrik Slabinje" sh.p.k	100,000
45	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	100,000
46	"Fatlum" sh.p.k	100,000
47	"Devoll Hydropower" sh.a	362,445
48	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	15,347
49	"Green Energy Trading Albania" sh.p.k	24,075
50	"Koxherri Energji" sh.p.k	100,000
51	"Alpiq Energy Albania" sh.p.k	100,000
52	"Energal" sh.p.k	100,000
53	"Euron Energy" sh.p.k	100,000
54	"Hec Kabash Porocan" sh.p.k	100,000
55	"Gama Energy" sh.p.k	152,198
56	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	100,000
57	"Lengarica & Energy" sh.p.k	100,000
58	"Mesopotam Energy" sh.p.k	100,000
59	"Denas Power" sh.p.k	100,000
60	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	100,000
61	C & S Energy sh.p.k	100,000
62	"Energjia D O O Veternik" sh.p.k	157
63	Nishova Energy sh.p.k	100,000
64	Perparimi SK sh.p.k	100,000
65	Dragobia Energy shpk	100,000
66	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	100,000
67	Hec Lashkiza sh.p.k	100,000
68	Liria Energji sh.p.k	100,000
69	Xhengo Energji sh.p.k	100,000
70	Energy Market Albania sh.p.k	100,000



VI	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	Total pagesa rregullatore 2021
71	DAAB Energy Group sh.p.k	100,000
72	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	100,000
73	"Balkan Energy Trade" sh.p.k	100,000
74	"Grid Energy" sh.p.k	23,796
75	"ALB-ENERGY" sh.p.k	100,000
76	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k	100,000
77	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k	100,000
78	"PPC Albania" sh.a.	100,000
79	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k	11,903
80	"ALIN TRADING" sh.p.k	100,000
81	"Albpetrol" sh.a	1,243,224
82	"THE BLUE STAR" sh.p.k	100,000
83	"BINDI" sh.p.k	100,000
84	"SMART Trade & Consulting" sh.p.k	12,558
85	"PRIMA ENERGY" sh.p.k	100,000
86	"SMART WATT" sh.p.k	100,000
87	"ReENERGY Trading Group" sh.p.k	304,527
88	"URADRIN" sh.p.k	100,288
89	"AEE" sh.p.k.	100,000
90	"ENER TRADE" sh.p.k	404,960
91	"HYDRO SETA" sh.p.k	100,000
92	"EZ-5 ENERGY" sh.p.k	100,000
93	"ENERGY 24 sh.p.k	100,000
94	"POWER AND GAS OPERATIONS" (PGO) sh.p.k	5,466
95	"TERNA ENERGY TRADING" sh.p.k	100,000
96	"SANG 1" sh.p.k	100,000
97	ENSCO TRADING (ALBANIA) sh.p.k	16,546
98	"AYEN AS ENERGJI" sh.a	100,000
99	"ELECTRAL BATRA HPP" sh.p.k	100,000
100	"KROI MBRET" sh.p.k	100,000
101	"AXPO ALBANIA" sh.a	25,564
102	"GEGA - G" sh.p.k.	100,000
103	"PowerComm" sh.p.k	100,000
104	"TIRANA ENERGJI" sh.p.k	100,000
105	"HEC ZALL XHUXHË" sh.p.k.	100,000
106	"C.G.C" sh.p.k	100,000
107	BALKGAZ sh.p.k	100,000
107	Total VI	13,721,148
304	TOTAL	207,280,362

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 52-2021-142-(36), datë 17.5.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Orjenca Pajtim Zeqiri, e datëlindjes 23.3.2002, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të shtetases Pajërma Zeqiri.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë